

PA PROGRES 2024



GJETJET KRYESORE DHE REKOMANDIME PRIORITARE
MONITORIMI I SESIONIT PARLAMENTAR JANAR – GUSHT 2024



INSTITUTI I
STUDIMEVE POLITIKE



INSTITUTE FOR
POLITICAL STUDIES

PA PROGRES

GJETJET KRYESORE DHE REKOMANDIME PRIORITARE
MONITORIMI I SESIONIT PARLAMENTAR JANAR – GUSHT 2024

2024

www.isp.com.al

Email: contactaips@isp.com.al / contactaips@gmail.com

Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

PËRMBLEDHJE MBI MONITORIMIN E SESIONIT PARLAMENTAR

GJETJET KRYESORE DHE REKOMANDIME PRIORITARE

Institucioni i Kuvendit të RSH, bazuar në Kushtetutë dhe në sistemin tonë qeverisës, **është institucioni kryesor përfaqësues dhe vendimmarrës**. Funkcionet e parlamentit nuk janë vetëm përfaqësuese dhe ligjvënëse, por edhe mbikëqyrëse dhe zgjedhore. Pavarësisht se është institucioni kryesor politik dhe Kuvendi zë vend të rëndësishëm në raportet vjetore të BE mbi Shqipërinë, ai dhe aktiviteti parlamentar monitorohen vetëm nga stafi i Institutit të Studimeve Politike (ISP). Midis viteve 2016-2023 monitorimi i plotë është kryer me mbështetje financiare nga partnerë perëndimorë (FES, Ambasada e Holandës dhe Ambasada e Zvicrës) dhe në disa aspekte (Kodi i Sjelljes, procesi mbikëqyrës, etj.) me mbështetje të ambasadës së SHBA dhe të Britanisë së Madhe.

Gjatë sesionit të fundit 2023 dhe sesionit aktual 2024 aktiviteti parlamentar **është monitoruar vullnetarisht nga stafi i ISP**, pa mbështetje financiare nga partnerë vendorë apo ndërkombëtarë. Kjo është e rëndësishme për të theksuar se ISP e vlerëson monitorimin periodik parlamentar si nevojë jetike për progresin demokratik në vend dhe pa këtë monitorim, de facto institucioni kryesor politik (parlamenti) mbetet i pa monitoruar. ISP do të përpiqet të vijojë monitorimet periodike edhe në të ardhmen.

Sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit të ISP bazohet **në të gjitha aspektet e aktivitetit parlamentar**. ISP nuk monitoron vetëm pjesën statistikore dhe formale në seancat plenare dhe komisione, por të gjithë aktivitetin parlamentar brenda e jashtë godinës parlamentare, nismat dhe ecurinë e tyre, praktikat dhe problematikat e funksionimit parlamentar, rolin e deputetëve në jetën politike dhe zonat zgjedhore, retorikën dhe cilësinë e produkteve parlamentare, pra një analizë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse. Raportet dhe deklaratimet e ISP publikohen gjerësisht në media dhe gjetjet përdoren si burime referimi dhe debati politik e mediatik.

Nga ana tjetër, në raportet monitoruese të sesioneve parlamentare media dhe vetë deputetët tregojnë vëmendje për vetëm dy aspekte teknike të monitorimit, **të cilat nuk janë thelbësore**: klasifikimin e deputetëve sipas nivelit të efikasitetit dhe rastet e deputetëve “të heshtur”, që nuk angazhohen në komisione ose në fjalime në seanca plenare. Në fakt, **gjetjet dhe rekomandimet** e raporteve periodike të ISP **janë pjesa më e rëndësishme**, për të cilën do të donim të tërhiqim vëmendjen e politikës, institucionit dhe medias.

Qëllimet kryesore të ISP dhe të monitorimit të thelluar janë **forcimi i integritetit dhe standardeve demokratike të funksionimit** të parlamentit, forcimi i transparencës dhe llogaridhënies, kthimi i funksioneve të parlamentit në pozitën e përcaktuar kushtetuese.

Ky angazhim profesional, i vlerësuar ndër vite nga partnerët, publiku dhe media, është e pritshme të ndeshet ndonjëherë edhe me pakënaqësi apo reagime kritike nga ndonjë politikan, zyrtar i lartë i Kuvendit, deputetë dhe parti politike, të cilat mund të kenë rezultuar me rekorde negative në gjetjet e raporteve tona. **E rëndësishme:** edhe në këtë sesion parlamentar shumica e deputetëve, përfshirë drejtues të rëndësishëm politikë të grupeve shprehën vlerësime për raportet monitoruese dhe rekomandimet e ISP-së.

Raportet institucionale midis ISP dhe Kuvendit **janë korrekte**, të gjitha produktet tona monitoruese dhe kërkimore ua adresojmë drejtuesve të Kuvendit dhe deputetëve; 15 deputetë nga tri partitë kryesore, përfshirë kryetarja e Kuvendit zonja Nikolla, morën pjesë gjatë 2024 në aktivitete dhe tryeza të ISP lidhur me gjetje e rekomandime për parlamentin. ISP siguroi diskutime politike dhe pjesëmarrje ndër-parlamentare edhe në rastet e konfliktualitetit të tyre politik, si dhe stafi i Kuvendit ka marrë pjesë në tryezat/takimet apo aktivitete në projektet tona.

Në tërësi, gjithnjë Kuvendi ka pranuar rekomandimet tona dhe ka pasur qasje reflektuese për t'i trajtuar, si dhe bazuar në to ka bërë disa përmirësime lidhur me publikimet online (statistika, dokumente, të dhëna financiare, etj).

Po ashtu, gjatë vitit 2024, ISP ka adresuar në Kuvend **disa opinione** mbi nisma ligjore ose raporte vjetore (**7 në total**), si dhe disa raporte monitorimi (**4 në total**), duke vijuar angazhimin profesional dhe konstruktiv.

Të gjitha raportet e ISP gjenden online në faqen zyrtare të ISP www.isp.com.al dhe në një faqe të dedikuar monitorimit periodik parlamentar www.deputetim.al.

- I. Gjatë sesionit parlamentar (2024) pati **progres relativ në kuptimin e funksionimit të parlamentit**, pas rikthimit të normalitetit në aktivitetet parlamentare në muajin mars. Vetë koncepti i “normalitetit” mbetet tregues jo i mjaftueshëm për të matur progresin demokratik, por bazuar në përvojat e mëparshme në Shqipëri, pjesëmarrja e të gjithë partive politike në aktivitetin parlamentar nuk duhet marrë e mirëqenë, edhe pse ky është një parakusht për një demokraci të qëndrueshme.
- II. Kuvendi **vijon të ketë rënie të besimit dhe mbështetjes publike**, kryesisht edhe për shkak të mënyrës sesi funksionon jeta parlamentare, konfliktualitetit politik, personalizimit, retorikës denigruese dhe distancës së madhe midis pritshmërive publike dhe produkteve parlamentare.
- III. **Këshilli i Ministrave vijoi të ishte burimi kryesor i nismave ligjore**. Ndonëse duket se ka rritje të numrit të nismave ligjore nga deputetët (mbi 23-25%) një pjesë e tyre janë nisma *de facto* të qeverisë, të paraqitura indirekt si nisma të deputetëve të mazhorancës dhe pjesa më e madhe janë nisma për çështje politike ditore, pa ndikim pozitiv në nevojat për reforma dhe mirëqeverisje.
- IV. **Kuvendi nuk arriti të përmbushë detyrimin kushtetues dhe ligjor për zgjedhjen e më shumë se 15 funksionarëve të lartë**, përfshirë zgjedhjen e Avokatit të Popullit (nga 2022) apo Komisionerit kundër Diskriminimit (nga 2023), anëtarëve në KLGJ, KLP, ISSK, KPP, KDRTSH, etj.
- V. **Kuvendi nuk e ushtroi në tërësi funksionin mbikëqyrës ndaj qeverisë**. Gjatë sesionit nuk pati seanca të dedikuara pyetjesh dhe as mocione besimi/mosbesimi, si dhe disa nisma për interpelanca me kryeministrin ose u refuzuan nga mazhoranca, ose u realizuan pjesërisht pa pjesëmarrjen e kryeministrit, por delegimin tek një ministër.
- VI. Kuvendi bëri **disa përpjekje për ushtrimin më transparent të funksionit mbikëqyrës** ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, duke krijuar akses për opinionet dhe rekomandime nga shoqëria civile. Megjithatë, në fazën fundore opinionet nuk u morën në konsideratë dhe rezolutat u miratuan si produkt negociatash midis Kuvendit dhe institucioneve, një praktikë që **krijon shqetësime** për transparencën dhe konceptin e mbikëqyrjes parlamentare.
- VII. Bazuar në **programin analitik të Këshillit të Ministrave 2024**, deri në gusht 2024 parlamenti do të duhej të kishte në program 34 drafte ligjore për vendimmarrje, por nga monitorimi

rezulton se qeveria ka depozituar vetëm 62% të tyre. **Në total 13 ligje (38%) nuk janë paraqitur** ndonëse është VKM dhe angazhim institucional e politik i qeverisë. Nga ana tjetër Kuvendi ka miratuar rreth 10 akte ligjore, që nuk janë pjesë e programit analitik, por nisma në kuadër të nevojave dhe prioriteteve politike afatshkurta.

- VIII. Kuvendi shënoi **disa akte të rëndësishme konsensuale (PS-PD)**, përfshirë ndryshimin në Kodin Zgjedhor (lidhur me listat e kandidatëve në zgjedhje e votën e diasporës), si dhe amnistinë për të burgosurit, por dështoi të realizojë reformën zgjedhore dhe dy aktet e mësipërme u shoqëruan me kritika publike për shkak të **mungesës së transparencës** (Kodi) dhe përfshirjes në amnisti të subjekteve të SPAK.
- IX. Kuvendi inicioi **dy komisione të posaçme** (kundër korrupsionit dhe kundër dezinformimit) nën drejtimin e dy prej figurave kryesore partiake të PS. Opozita nuk ka pranuar (ende) të jetë pjesë e tyre. Nismat kanë krijuar shqetësime lidhur me objektin e paqartë të tyre, mbivendosjet ndaj komisioneve të tjera, qasjes metodologjike dhe përdorimit politik të tyre si arritje e partisë në pushtet. Duke vlerësuar se roli i shoqërisë civile është monitorues, adresues me opinione dhe rekomandime, si dhe vlerësues i performancës, disa organizata të njohura kanë informuar komisionet se nuk do të jenë pjesë e strukturave të tyre teknike.
- X. Sesioni aktual 2024 nisi me ndërprerjen e mandatit të deputetit Ahmetaj, ish-zv/kryeministër i shpallur në kërkim ndërkombëtar për korrupsion. Gjatë kësaj periudhe **8 deputetë u paraqitën në SPAK në kuadër të hetimeve të ndryshme**, disa prej të cilave kanë të bëjnë me vetë deputetët si subjekt hetimi. Vetë Kuvendi e shndërroi seancën dëgjimore me drejtuesin e SPAK (në komision dhe në seancë plenare) në një prej seancave më të gjata, me tone agresive dhe akuza të shumta politike.
- XI. Një vendim i rëndësishëm i Gjykatës Kushtetuese (**mandati i zonjës Xhaçka**) në mënyrë të pajustificueshme dhe të pabazuar në aktet rregullatore, u injorua nga Kuvendi. Retorika denigruese politike ndaj institucioneve të pavarura, si p.sh., sulmet e vazhdueshme ndaj **drejtuesit të SPAK, presioni politik në komision ndaj kryetarit të KLSH**, nxorën gjithashtu në pah përpjekjen e partive, deputetëve apo grupeve të caktuara për të kufizuar apo cenuar pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, një shqetësim ky në rritje për të ardhmen.
- XII. Sesioni i fundit parlamentar shënoi **“mungesën aktive” të liderëve politikë** në debatin parlamentar, rasti i parë i tillë gjatë gjithë periudhës së tranzicionit. Kryetari i PS, Edi Rama mori pjesë vetëm në një debat, mbajti vetëm një fjalim dhe i delegoi kërkesat për interpelancë tek ish-ministrja për marrëdhëniet me parlamentin. Kryetari i PD, Sali Berisha vijon të jetë në kufizim me masë sigurie gjatë gjithë sesionit parlamentar, duke pamundësuar

pjesëmarrjen parlamentare. Kryetari i PL, Ilir Meta nuk është deputet dhe kryetari i PD (II) Lulzim Basha mori pjesë vetëm në dy debate parlamentare.

- XIII. **Presidenti i Republikës** vazhdimisht deklaroi se në vlerësimin e firmës së tij për ligjet do të bazohet në përputhshmërinë e akteve me Kushtetutën, jo me elementët e tjerë, siç kanë bërë presidentët e mëparshëm, përfshirë edhe vlerësimet mbi procedurat e ndjekura për miratim apo reagimet/kërkesat e grupeve të ndryshme të interesit. Në fakt, disa prej ligjeve të dekretuara u rrëzuan pjesërisht nga Gjykata Kushtetuese, tregues se kriteri vlerësues i deklaruar nga Presidenti **nuk rezultoi të ishte i saktë**.
- XIV. Në fundin e muajit korrik Kuvendi ndryshoi **pa sqarime publike dy nga tre drejtuesit kryesorë** (kryetarin dhe zv/kryetarin), si dhe gjatë sesionit dy partitë e mëdha ndryshuan kryetarët e grupeve parlamentare dhe disa drejtues të tjerë në komisione. Ndryshimet e vazhdueshme reflektojnë zhvillimet e brendshme politike në prag të vitit zgjedhor, por në thelbin e tyre konfirmojnë mbipushtetin e partive ndaj parlamentit, me pasoja negative në integritetin dhe llogaridhënien e parlamentit.
- XV. **Deputetët më efektivë** vijuan të jenë **pothuajse të njëjtët** si në sesionet e mëparshme parlamentare: Erion Braçe (PS), Jorida Tabaku (PD), Ina Zhupa (PD), Bujar Leskaj (PD), Petrit Vasili (PL), Klotilda Bushka (PS), Tritan Shehu (PD), etj. Deputetët e PSD vijnë me rekorde negative (nën 13%) në fund të renditjes, kurse partitë e tjera kanë kuota nën 30%.
- XVI. **Gratë deputete vijuan të shënojnë nivel shumë më të lartë angazhimi** dhe efikasiteti sesa deputetët e gjinisë tjetër. Në vlerësimin e përgjithshëm gratë deputete patën mesatare prej 37% të efikasitetit parlamentar ndaj vetëm 33% të gjinisë tjetër. Vlerësimi nuk përfshin cilësinë e angazhimit, e cila mbetet kritike për dy gjinitë, por nivelin e përgjithshëm të angazhimit në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësiive parlamentare.
- XVII. Gjatë sesionit dhe legjislaturës disa vendime të parlamentit **u rrëzuan pjesërisht ose tërësisht si antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese**. Në asnjë rast Kuvendi dhe as grupet parlamentare nuk reflektuan ndaj deputetëve përgjegjës për nisma të tilla dhe as praktikave të tilla vendimmarrëse, duke dëshmuar se edhe në të ardhmen priten sjellje të tilla me kosto politike për vendin.
- XVIII. Në këtë sesion vetëm një **nismë ligjore erdhi nga mbi 20 mijë nënshkrime** të qytetarëve, edhe në këtë rast nga një grupim që ka deklaruar konkurrimin si subjekt politik në zgjedhjet e radhës (“Shqipëria bëhet”). Nisma nuk pati ndikim në vendimmarrjen përkatëse nga Kuvendi.

- XIX. Kryetarja e Kuvendit lajmëroi në fundin e muajit korrik se **ka depozituar dhuratat në regjistrin e posaçëm, praktikë pozitive**, që aplikohet për herë të parë në Kuvend. Gjatë sesionit nuk pati asnjë rast të deklarimit publik të gjendjes në **konflikt interesi të deputetëve**, ndonëse raportime të shumta ofruan të dhëna kritike për ekzistencën e tij. Deklarimet në aktivitetet e të tretëve munguan edhe këtë sesion, tregues tjetër i devijimeve nga standardet e Kodit të Sjelljes.
- XX. Gjatë sesionit së paku në një rast votimi gjatë seancës plenare **u përsërit për shkak të shkeljes së Rregullores dhe akteve procedurale**, praktikë që nuk është zbatuar në raste të ngjashme shkeljesh këtë sesion dhe sidomos gjatë sesionit të kaluar parlamentar (2023). Devijimi dhe interpretimi i njëanshëm i procedurave parlamentare vijoi të mbetet shqetësim dhe një prej burimeve të konfliktit politik.
- XXI. Kuvendi zhvilloi në disa raste **seanca të gjata pune**, deri në mesnatë ose në orët e para të mëngjesit. Nevoja për vendimmarrje sasiore dhe konsumimin e programit të punës nuk mori në konsideratë detyrimet e Kuvendit për transparencë publike. Debatet parlamentare bëhen për vendin dhe qytetarët, ndaj për të qenë efektive duhen evituar raste të tilla abuzive.
- XXII. Kuvendi **ofroi statistika** me të dhëna për aktivitetin parlamentar, një zhvillim ky pozitiv, megjithatë rezulton se nuk ka njësim të statistikave në disa kategori të publikimeve të Kuvendit dhe se shifrat pa informacion shoqërues **nuk ofrojnë informacion cilësor dhe shterues** lidhur me standardet e transparencës. Megjithatë, drejtuesit e institucionit dhe zyrtarët përgjegjës për informim në Kuvend iu përgjigjën pozitivisht në çdo rast kërkesave të ISP për informacion.

- I. Instituti i Studimeve Politike (ISP), por edhe disa organizata të shoqërisë civile **kanë adresuar rekomandime konkrete në Kuvend** për reformimin e bazës ligjore rregullatore (**Rregullorja e Kuvendit, Kodi i Sjelljes, Ligji për statutin e deputetit**, rregulloret e grupeve parlamentare, etj). Rekomandimet janë shoqëruar me sugjerimin që procesi të jetë gjithëpërfshirës dhe të zhvillohet **gjatë këtij sesioni për të hyrë në fuqi në legjislaturën e ardhshme parlamentare**. Kjo do të ishte një formë efektive për ndryshime cilësore dhe të qëndrueshme. Palët politike kryesore kanë deklaruar dakordësinë parimore të tyre, pritet nëse do të ketë rezultate konkrete në sesionin e vjeshtës 2024.
- II. Kuvendi dhe drejtuesit e rinj kanë përgjegjësinë të sigurojnë përmbushjen e funksioneve të institucionit, sipas përcaktimit kushtetues dhe ligjor. **Funksioni ligjvënës, mbikëqyrës dhe zgjedhor duhet të jenë prioritetet kryesore** të aktivitetit dhe programit parlamentar.
- III. Kuvendi mund e duhet të ketë **qasje pozitive ndaj kërkesave për interpelanca, seanca pyetjesh, kërkesave për informacion apo për komisione hetimore**, duke i dhënë prioritet normës kushtetuese dhe evituar refuzimet apriori për motive politike ditore. Kuvendi duhet të ndikojë që kryeministri t'u përgjigjet direkt deputetëve për kërkesa që lidhen me funksionin e tij.
- IV. Kuvendi mund dhe duhet të adresojë institucionalisht **problematikat lidhur me interpretimin e procedurës dhe Rregullores** në komisione dhe në seancën plenare, duke parandaluar incidentet dhe rastet shqetësuese dhe rritur integritetin e aktivitetit parlamentar.
- V. Kuvendi mund dhe duhet të **reformojë aktivitetin e komisioneve** parlamentare, duke ofruar transparencë dhe llogaridhënie, duke shmangur rastet e **ndikimeve informale** dhe devijimit nga programet e miratuara, duke nxitur dialogun dhe pjesëmarrjen konstruktive parlamentare.
- VI. Kuvendi mund dhe duhet të dëshmojë **respekt të ndërsjelltë institucional** për institucionet kushtetuese e të pavarura, duke evituar retorikën dhe qasjet denigruese apo të personalizuara. Mbikëqyrja parlamentare nuk nënkupton të drejtën e kontrollit dhe ndikimit politik.
- VII. Seancat **mujore për zgjedhësit** paraqesin problematika, të cilat mbeten në kuadër të diskutimeve. Kuvendi duhet të krijojë një **mekanizëm efektiv**, që adreson problematikat dhe kërkon/monitoron realizimin e tyre, si formë për të rritur besimin publik tek deputetët dhe vetë institucioni.

- VIII. Kuvendi ka nevojë të **reformojë dhe standardizojë sistemin online** të paraqitjes së informacionit, përfshirë database, detyrimet nga Kodi i Sjelljes dhe platformën e konsultimit.
- IX. Kuvendi mund të **organizojë sesione mujore informuese dhe llogaridhënese** për median, me pjesëmarrjen e drejtuesve nga të gjitha palët politike, si dhe të trajtojë në mënyrë thelbësore e konstruktive raportet, deklaratimet dhe kërkesat që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile.

Bashkëngjitur keni edhe të dhënat e detajuara të klasifikimit të efikasitetit parlamentar (janar-gusht 2024), nivelin e përfaqësimit mbi bazë partish dhe qarqesh, si dhe korelacionin midis nivelit të efikasitetit dhe përfitimeve ligjore financiare nga deputetët.

ANEKS 1.

RENDITJA E DEPUTETËVE SIPAS NIVELIT TË EFIKASITETIT

Bazuar në metodologjinë e ndjekur gjatë 8 viteve të fundit në monitorimin parlamentar (vlerësim për nismat ligjore, për propozimet individuale ligjore, për pjesëmarrjen aktive në debatet në komisionet parlamentare dhe në seancat plenare, për interpelancat dhe pyetjet adresuar institucioneve, për angazhimin në publik dhe zonë elektorale, për pjesëmarrje në votimin parlamentar).

Numri maksimal i pikëve është 100 dhe deputetët janë vlerësuar sipas të dhënave monitoruese për secilin kriter (shih tabelën e detajuar bashkëngjitur).

20 DEPUTETËT ME NIVELIN MË TË LARTË TË EFIKASITETIT			
RENDITJA	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI POLITIK	NGA 100 PIKË
1	ERION BRAÇE	PS	77.0
	INA ZHUPA	PD	77.0
	JORIDA TABAKU	PD	77.0
4	BUJAR LESKAJ	PD	72.0
	PETRIT VASILI	PL	72.0
6	TRITAN SHEHU	PD	64.0
7	KLOTILDA BUSHKA	PS	63.0
8	ETILDA GJONAJ	PS	62.0
9	ALBANA VOKSHI	PD	61.0
	EDUARD SHALSI	PS	61.0
11	AGRON SHEHAJ	PAV	58.0
	DHURATA ÇUPI	PD	58.0
13	NASIP NAÇO	PS	57.0
14	GAZMENT BARDHI	PD	56.0
15	ERISA XHIXHO	PL	55.0
16	OERD BYLYKBASHI	PD	52.0
17	ASLLAN DOGJANI	PD	51.0
	PETRO KOÇI	PS	51.0
19	DENIS DELIU	PS	50.0
	ERVIN SALIANJI	PD	50.0

Nga ana tjetër në vijim është renditja e deputetëve me nivelin më të ulët të efikasitetit gjatë sesionit të fundit parlamentar. Në listë kryesojnë pothuajse të njëjtit deputetë si edhe në sesionet e kaluara parlamentare, kryesisht deputetë – biznesmenë që sigurojnë mandate personale në zona të ndryshme, deputetët e PSD dhe deputetë të tjerë me të dhëna specifike, përfshirë edhe figura të njohura politike që vijojnë të injorojnë detyrimet dhe përgjegjësitë parlamentare.


20 DEPUTETËT ME NIVELIN MË TË ULËT TË EFIKASITETIT			
RENDITJA	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI POLITIK	NGA 100 PIKË
129	AGRON ÇELA	PS	10.7
128	GLEDIS ÇELIKU	PSD	11.3
123	GERTJAN DEDA	PSD	12.0
124	NIKO KURI	PS	12.0
	ORNALDO RAKIPI	PS	12.0
	SHKELQIM BULLARI	PS	12.0
	TATIANA PIRO	PS	12.0
121	EDI PALOKA	PD	13.0
	LODOVIK HASANI	PD	13.0
120	MESILA DODA	PDIU	15.0
117	ANDUEL TAHIRAJ	PS	16.0
	LUAN DUZHA	PS	16.0
	MERI MARKIÇI	PSD	16.0
115	ILIR NDRAXHI	PS	17.0
	ILIR TOPI	PS	17.0
110	GERTA DURAKU	PS	18.0
	LULJETA BOZO	PS	18.0
	PAULIN STERKAJ	PS	18.0
	ORIELA NEBIJ	PD2	18.0
	VANGJEL DULE	PBDNJ	18.0

Deputeti Berisha nuk ka qenë pjesë e aktivitetit parlamentar për arsyt e njohura.

ANEKS II


NIVELI I EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE SIPAS PARTIVE DHE QARQEVE

Lidhur me nivelin e angazhimit sipas partive politike, rekord pozitiv vijon të mbetet Partia e Lirisë dhe rekord negativ Partia Socialdemokrate. Tek rasti i PL vlen edhe fakti se dy nga tre deputetët e saj janë shumë aktivë në parlament, ndërkohë që partitë e mëdha politike PS e PD kanë deputetë shumë aktivë dhe shumë jo aktivë, ndaj kanë edhe tregues efikasiteti mesatar dukshëm më poshtë se PL. Vlen të theksohet gjithashtu se dy PD-të kanë nivel më të lartë angazhimi sesa PS, ndonëse kjo e fundit është solide në mazhorancë dhe në disa seanca gjatë muajve janar-mars ishte e vetme në pjesëmarrjen aktive parlamentare.



Nga të dhënat e përpunuara mbi nivelin e efikasitetit të deputetëve sipas mandateve të konfirmuara zyrtarisht nga KQZ, rezulton edhe më tej se qarku Shkodër ka nivelin më të ulët të përfaqësimit dhe angazhimit parlamentar, ndjekur nga qarqet Kukës, Lezhë dhe Korçë. Nivelin më të lartë të angazhimit e kanë qarqet Gjirokastër dhe Fier.

EFIKASITETI I DEPUTETËVE SIPAS QARQEVE



ANEX III

DEPUTETËT ME “O” ANGAZHIME NË KUVEND, NË KOMISIONE DHE/OSE NË SEANCA

Nga të dhënat monitoruese janë gjashtë deputetësh që nuk kanë arritur të lënë “gjurmë parlamentare” në sesionin e fundit parlamentar, duke mos pasur asnjë angazhim personal NË komisionet e Kuvendit dhe as në seancat plenare. Nuk është vetëm çështje statistikore (0 fjalime), por është shumë më komplekse, - ata nuk kanë iniciuar asgjë, nuk kanë bërë asnjë propozim, nuk kanë folur për asgjë dhe nuk kanë ushtruar kështu pjesën më të madhe të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore parlamentare.

DEPUTETI/E	PARTIA	KOMISIONE	SEANCË
AGRON ÇELA	PS	X	X
GERTJAN DEDA	PSD	X	X
GLEDIS ÇELIKU	PSD	X	X
NIKO KURI	PS/MEGA	X	X
SHKELQIM BULLARI	PS	X	X
TATIANA PIRO	PS	X	X
EDI PALOKA	PD	X	
LODOVIK HASANI	PD	X	
MESILA DODA	PDIU	X	
SHPETIM IDRIZI	PDIU	X	
VANGJEL DULE	PBDNJ	X	
ANDUEL TAHIRAJ	PS		X
BUJAR ÇELA	PS		X
FRROK GJINI	PS		X
HELIDON BUSHATI	PD		X
ILIR NDRAXHI	PS		X
ILIR TOPI	PS		X
LUAN DUZHA	PS		X
LULJETA BOZO	PS		X
MERI MARKIÇI	PSD		X
ORNALDO RAKIPI	PS		X
PAULIN STERKAJ	PS		X
SELADIN JAKUPLLARI	PD2		X

ANEKS IV

20 DEPUTETËT MË SHUMË/PAK TË PAGUAR NË SESIONIN E FUNDIT PARLAMENTAR

Një nga treguesit e monitorimit ishte përpjekja për të bërë ndërlidhjen midis nivelit të efikasitetit të deputetëve dhe përfitimeve të tyre financiare, sipas ligjit. Tabela e mëposhtme paraqet 20 deputetët me nivelin më të lartë të të ardhurave financiare nga aktiviteti parlamentar gjatë sesionit të fundit parlamentar, si dhe 20 deputetët me nivelet më të ulta të të ardhurave financiare.

Tipar dallues është fakti se deputetët nga qarqet e largëta kanë edhe përfitimet më të mëdha financiare, dhe se në listën e deputetëve më të paguar bëjnë pjesë disa prej atyre që nuk kanë pasur pothuajse asnjë produkt parlamentar (nismë ligjore, propozim, interpelancë, apo pjesëmarrje aktive në komisione ose në seancat plenare). Në pjesën tjetër të listës bëjnë pjesë kryesisht deputetë të Tiranës (banojnë në Tiranë).

Për informacion, deputetët, përveç pagesës standard përfitojnë të ardhura nga pjesëmarrjet në komisione dhe në aktivitetet e tjera parlamentare, nga shërbimet mbështetëse (kuotë telefonike dhe pagesa për qira banese ose dieta udhëtimesh), etj.

Në tërësi, duke nisur nga pranvera e vitit 2023 deputetët aktualë janë njëherësh deputetët më të paguar të gjitha legjislativave të tranzicionit, një vendim që u mor në mënyrë konsensuale prej tyre. Në terma të thjeshtë, pagesa mujore e deputetëve është rreth 2 deri 2.5 mijë euro pa llogaritur përfitimet shtesë që variojnë deri në 2 mijë euro të tjera.

TË DHËNAT PËR TË ARDHURAT E DEPUTETËVE NË SESIONIN JANAR-GUSHT 2024					
20 DEPUTETËT ME TË ARDHURAT MË TË LARTA			20 DEPUTETËT ME TË ARDHURAT MË TË ULËTA		
1	ENSLEMVERA ZAKE	3,228,017	1	SALI BERISHA	430,013
2	ANTONETA DHIMA	3,091,704	2	AGRON SHEHAJ	1,471,453
3	MIRELA PITUSHI	3,072,297	3	ORJELA NEBIJAJ	1,585,660
4	TEUTA RAMAJ	3,057,035	4	BUJAR LESKAJ	1,663,063
5	FADIL NASUFI	3,055,335	5	LULZIM BASHA	1,776,906
6	NUSTRET AVDULLA	3,051,780	6	FLAMUR HOXHA	1,835,275
7	BAFTJAR ZEQAJ	3,046,835	7	AGRON ÇELA	1,934,981

8	PRANVERA RESULAJ	3,046,495	8	ETILDA GJONAJ	1,945,511
9	HATIXHE KONOMI	3,040,742	9	FATMIR XHAFA	1,974,033
10	GËZIM ADEMAJ	3,033,197	10	PETRIT DODA	1,976,813
11	ANDUEL TAHIRAJ	3,031,497	11	PANDELI MAJKO	1,977,434
12	ERALDA BANO	3,031,059	12	EDI PALOKA	2,004,518
13	KLEVIS XHOXHI	3,015,167	13	FATMIR MEDIU	2,056,975
14	MERI MARKIÇI	3,014,496	14	LAERT DURAJ	2,063,519
15	GLEDIS ÇELIKU	3,000,782	15	FLAMUR NOKA	2,073,670
16	DASANTILA TAHIRAJ	2,992,991	16	LEFTER GESHTENJA	2,095,413
17	KLODIANA SPAHIU	2,972,963	17	ENKELEJD ALIBEAJ	2,104,942
18	ARBI AGALLIU	2,959,790	18	ORJOLA PAMPURI	2,135,489
19	SORINA KOTI	2,958,167	19	ERMONELA FELAJ	2,141,185
20	ILIRJAN PENDAVINJI	2,947,915	20	KRESHNIK ÇOLLAKU	2,150,392

ANEKS V:

TË DHËNAT E DETAJUARA TË EFEKTIVITETIT (AKTIVITETIT PARLAMENTAR) TË DEPUTETËVE

NR	EMRI MBIEMRI	GRUPI POLITIK	GJ	NISMA LIGJORE	PROPOZIME LIGJ/POL	ANG+DISK SEANCË	PJES/DIS KOMISIONE	KËRKESA / INFO.	INTERPE LANCË	VOTIM I LIGJEVE %	PUBLIK / TE TJERA	TOTALI 100 PIKË
1	Agron Çela	PS	M	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	8.7	2.0	10.7
2	Agron Duka	PAA	M	5.0	5.0	3.0	4.0	0.0	0.0	10.0	5.0	32.0
3	Agron Gjckmarkaj	PD	M	0.0	0.0	9.0	4.0	0.0	0.0	10.0	4.0	27.0
4	Agron Shehaj	PAV	M	5.0	3.0	13.0	4.0	5.0	10.0	10.0	8.0	58.0
5	Alban Xhelili	PS	M	5.0	0.0	2.0	10.0	0.0	0.0	10.0	5.0	32.0
6	Albana Vokshi	PD	F	5.0	0.0	13.0	10.0	5.0	10.0	10.0	8.0	61.0
7	Andia Ulliri	PD2	F	4.0	5.0	4.0	8.0	3.0	5.0	10.0	8.0	47.0
8	Anduel Tahiraj	PS	M	0.0	0.0	0.0	4.0	0.0	0.0	10.0	2.0	16.0
9	Antoneta Dhima	PS	F	0.0	5.0	14.0	16.0	0.0	0.0	10.0	4.0	49.0
10	Arben Pëllumbi	PS	M	3.0	0.0	6.0	20.0	0.0	0.0	10.0	4.0	43.0
11	Arbi Agalliu	PD2	M	5.0	5.0	1.0	6.0	3.0	10.0	10.0	4.0	44.0
12	Arkend Balla	PS	M	0.0	0.0	2.0	10.0	0.0	0.0	10.0	3.0	25.0
13	Asllan Dogjani	PD	M	3.0	3.0	17.0	10.0	3.0	0.0	10.0	5.0	51.0
14	Aurora Mara	PS	F	0.0	0.0	1.0	4.0	0.0	0.0	10.0	3.0	18.0
15	Baftjar Zeqaj	PS	M	3.0	0.0	3.0	6.0	3.0	0.0	10.0	3.0	28.0
16	Bardhyl Kollçaku	PS	M	3.0	0.0	9.0	16.0	0.0	0.0	10.0	4.0	42.0
17	Bledar Çuçi	PS	M	5.00	0.0	2.0	0.0	0.0	0.0	10.0	7.0	24.0
18	Bledjon Nallbati	PD	M	3.0	0.0	3.0	6.0	0.0	0.0	9.3	5.0	26.3
19	Blendi Klosi	PS	M	0.0	0.0	3.0	10.0	0.0	0.0	10.0	5.0	28.0
20	Blerina Gjylameti	PS	F	3.0	0.0	8.0	12.0	0.0	0.0	10.0	5.0	38.0
21	Bujar Çela	PS	M	0.0	0.0	0.0	6.0	0.0	0.0	9.3	4.0	19.3
22	Bujar Leskaj	PD	M	10.0	7.0	15.0	14.0	5.0	3.0	10.0	8.0	72.0
23	Damian Gjcknuri	PS	M	0.0	5.0	4.0	6.0	0.0	0.0	10.0	8.0	33.0
24	Dasantila Tahiraj	PS	F	0.0	0.0	2.0	8.0	0.0	0.0	10.0	4.0	24.0
25	Dashamir Shehi	LZHK	M	5.0	5.0	11.0	8.0	0.0	0.0	10.0	4.0	43.0
26	Dashnor Sula	PD	M	5.0	0.0	15.0	8.0	3.0	0.0	10.0	8.0	49.0
27	Denis Deliu	PS	M	4.0	0.0	10.0	16.0	3.0	0.0	10.0	7.0	50.0
28	Dhurata Çupi	PD	F	5.0	5.0	8.0	17.0	5.0	0.0	10.0	8.0	58.0
29	Edi Paloka	PD	M	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	0.0	10.0	2.0	13.0
30	Edmond Spaho	PD	M	5.0	0.0	8.0	12.0	3.0	0.0	10.0	4.0	42.0
31	Edona Bilali	PS	F	0.0	0.0	10.0	8.0	0.0	0.0	10.0	4.0	32.0
32	Eduard Ndreca	PS	M	2.0	0.0	4.0	12.0	0.0	0.0	10.0	4.0	32.0
33	Eduard Shalsi	PS	M	5.0	5.0	9.0	20.0	3.0	0.0	10.0	9.0	61.0
34	Elda Hoti	PD	F	0.0	0.0	13.0	4.0	3.0	0.0	10.0	6.0	36.0
35	Emilja Koliqi	PD	F	4.0	4.0	9.0	10.0	3.0	0.0	10.0	6.0	46.0
36	Enkelejd Alibeaj	PD2	M	5.0	5.0	4.0	9.0	3.0	5.0	10.0	5.0	46.0
37	Enslmvera Zake	PS	F	0.0	0.0	4.0	14.0	0.0	0.0	10.0	3.0	31.0
38	Eralda Bano	PD2	F	3.0	0.0	5.0	10.0	3.0	5.0	10.0	4.0	40.0
39	Erion Braçe	PS	M	10.0	9.0	15.0	18.0	5.0	0.0	10.0	10.0	77.0
40	Erisa Xhixho	PL	F	6.0	7.0	3.0	5.0	5.0	10.0	10.0	9.0	55.0
41	Ermonela Felaj	PS	F	5.0	0.0	7.0	10.0	5.0	0.0	10.0	7.0	44.0
42	Ervin Saliqj	PD	M	3.0	0.0	3.0	12.0	5.0	10.0	10.0	7.0	50.0
43	Etilda Gjonaj	PS	F	5.0	5.0	11.0	20.0	5.0	0.0	10.0	6.0	62.0
44	Etjen Xhafaj	PS	M	3.0	0.0	10.0	14.0	0.0	0.0	10.0	5.0	42.0
45	Evis Kushi	PS	F	3.0	3.0	7.0	20.0	0.0	0.0	10.0	5.0	48.0
46	Fadil Nasufi	PS	M	3.0	0.0	6.0	10.0	0.0	0.0	10.0	3.0	32.0
47	Fatmir Mediu	PR	M	2.0	0.0	1.0	6.0	0.0	0.0	10.0	6.0	25.0
48	Fatmir Xhafaj	PS	M	5.0	0.0	4.0	4.0	5.0	0.0	9.3	7.0	34.3

49	Ferdinant Xhaferaj	PD	M	3.0	0.0	9.0	14.0	0.0	0.0	10.0	4.0	40.0
50	Flamur Hoxha	PD	M	0.0	0.0	1.0	4.0	0.0	0.0	10.0	4.0	19.0
51	Flamur Noka	PD	M	0.0	0.0	13.0	4.0	0.0	0.0	9.3	7.0	33.3
52	Florenc Spaho	PS	M	0.0	0.0	6.0	14.0	0.0	0.0	10.0	4.0	34.0
53	Flutura Aça	PD2	F	3.0	0.0	6.0	16.0	3.0	5.0	10.0	6.0	49.0
54	Frok Gjini	PS	M	0.0	0.0	0.0	8.0	0.0	0.0	10.0	3.0	21.0
55	Gazment Bardhi	PD	M	5.0	5.0	10.0	10.0	7.0	0.0	10.0	9.0	56.0
56	Gerta Duraku	PS	F	0.0	0.0	2.0	4.0	0.0	0.0	10.0	2.0	18.0
57	Gertjan Deda	PSD	M	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	10.0	2.0	12.0
58	Gezim Ademaj	PD-PDIU	M	0.0	0.0	3.0	4.0	0.0	0.0	10.0	3.0	20.0
59	Gledis Çeliku	PSD	M	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	9.3	2.0	11.3
60	Greta Bardeli	PD	F	3.0	0.0	8.0	6.0	2.0	0.0	10.0	6.0	35.0
61	Hatixhe Konomi	PS	F	0.0	0.0	5.0	16.0	0.0	0.0	10.0	3.0	34.0
62	Helidon Bushati	PD	M	0.0	0.0	0.0	8.0	0.0	0.0	10.0	4.0	22.0
63	Ilda Dhori	PD	M	3.0	0.0	11.0	8.0	3.0	0.0	10.0	5.0	40.0
64	Ilir Metaj	PS	M	0.0	0.0	2.0	5.0	0.0	0.0	10.0	2.0	19.0
65	Ilir Ndraxhi	PS	M	0.0	0.0	0.0	4.0	0.0	0.0	10.0	3.0	17.0
66	Ilir Topi	PS	F	0.0	0.0	0.0	4.0	0.0	0.0	10.0	3.0	17.0
67	Ilirian Pendavinji	PS	M	0.0	0.0	2.0	14.0	3.0	0.0	10.0	5.0	34.0
68	Ina Zhupa	PD	F	5.0	5.0	18.0	14.0	6.0	10.0	10.0	9.0	77.0
69	Ismet Beqiraj	PS	M	0.0	5.0	4.0	12.0	0.0	0.0	10.0	4.0	35.0
70	Isuf Çelaj	PD	M	0.0	0.0	13.0	8.0	2.0	0.0	10.0	5.0	38.0
71	Jorida Tabaku	PD	F	5.0	9.0	15.0	18.0	7.0	3.0	10.0	10.0	77.0
72	Jurgis Çyrbja	PS	M	0.0	0.0	4.0	10.0	0.0	0.0	10.0	3.0	27.0
73	Kasëm Mahmutaj	PD	M	0.0	0.0	4.0	10.0	0.0	0.0	10.0	3.0	27.0
74	Kastriot Piroli	PD	M	0.0	0.0	3.0	4.0	0.0	0.0	10.0	4.0	21.0
75	Klevis Xhoxhi	PS	M	3.0	5.0	3.0	10.0	3.0	0.0	9.3	5.0	38.3
76	Klodiana Spahiu	PS	F	3.0	0.0	4.0	20.0	0.0	0.0	9.3	3.0	39.3
77	Klotilda Bushka	PS	F	7.0	5.0	9.0	18.0	5.0	0.0	10.0	9.0	63.0
78	Kreshnik Çollaku	PD2	M	2.0	0.0	1.0	10.0	2.0	3.0	10.0	5.0	33.0
79	Laert Duraj	PS	M	3.0	0.0	3.0	8.0	0.0	0.0	10.0	3.0	27.0
80	Lavdrim Krrashi	PS	M	4.0	0.0	2.0	16.0	2.0	0.0	10.0	8.0	42.0
81	Lefter Gështenja	PD	M	2.0	0.0	13.0	10.0	2.0	0.0	10.0	5.0	42.0
82	Lindita Buxheli	PS	F	0.0	0.0	3.0	14.0	0.0	0.0	10.0	3.0	30.0
83	Lindita Metaliaj	PD	F	2.0	0.0	9.0	6.0	0.0	0.0	10.0	5.0	32.0
84	Lodovik Hasani	PD	M	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	0.0	10.0	2.0	13.0
85	Luan Baçi	PD	M	3.0	0.0	16.0	8.0	3.0	0.0	10.0	8.0	48.0
86	Luan Duzha	PS	M	0.0	0.0	0.0	4.0	0.0	0.0	10.0	2.0	16.0
87	Luljeta Bozo	PS	F	0.0	0.0	0.0	6.0	0.0	0.0	10.0	2.0	18.0
88	Lulzim Basha	PD2	M	5.0	5.0	2.0	0.0	0.0	0.0	8.7	4.0	24.7
89	Meri Markiçi	PSD	F	0.0	0.0	0.0	4.0	0.0	0.0	10.0	2.0	16.0
90	Merita Baku	PD2	F	2.0	0.0	6.0	10.0	2.0	5.0	10.0	6.0	41.0
91	Mesila Doda	PDIU	F	0.0	0.0	2.0	0.0	0.0	0.0	10.0	3.0	15.0
92	Milva Ekonomi	PS	F	3.0	0.0	9.0	14.0	4.0	0.0	10.0	4.0	44.0
93	Mimi Kodheli	PS	F	3.0	0.0	5.0	20.0	3.0	0.0	10.0	5.0	46.0
94	Mirela Pitushi	PS	F	0.0	0.0	5.0	8.0	0.0	0.0	10.0	4.0	27.0
95	Monika Kryemadhi	PL	F	0.0	10.0	2.0	8.0	3.0	0.0	10.0	6.0	39.0
96	Nasip Naço	PS	M	5.0	5.0	8.0	20.0	3.0	0.0	10.0	6.0	57.0
97	Niko Kuri	PS	M	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	10.0	2.0	12.0
98	Nustret Avdulla	PDIU	M	0.0	0.0	1.0	8.0	0.0	0.0	10.0	3.0	22.0
99	Oerd Bylykbashi	PD	M	5.0	5.0	10.0	10.0	4.0	0.0	10.0	8.0	52.0
100	Olta Xhaça	PS	F	0.0	0.0	1.0	6.0	0.0	0.0	10.0	3.0	20.0
101	Oriela Nebiaj	PD2	F	0.0	0.0	1.0	4.0	0.0	0.0	10.0	3.0	18.0
102	Orjola Pampuri	PD2	F	3.0	0.0	2.0	6.0	3.0	5.0	10.0	4.0	33.0
103	Ornaldo Rakipi	PS	M	0.0	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	10.0	1.0	12.0
104	Pandeli Majko	PS	M	3.0	0.0	5.0	10.0	3.0	0.0	10.0	5.0	36.0

105	Paulin Sterkaj	PS	M	0.0	0.0	0.0	6.0	0.0	0.0	10.0	2.0	18.0
106	Petrit Doda	PD-PLL	M	2.0	0.0	11.0	4.0	0.0	0.0	10.0	5.0	32.0
107	Petrit Vasili	PL	M	5.0	7.0	17.0	20.0	5.0	0.0	10.0	8.0	72.0
108	Petro Koçi	PS	M	4.0	3.0	12.0	15.0	3.0	0.0	10.0	4.0	51.0
109	Plarent Ndreca	PS	M	0.0	0.0	2.0	14.0	3.0	0.0	10.0	4.0	33.0
110	Pranvera Resulaj	PS	F	3.0	0.0	12.0	12.0	3.0	0.0	10.0	4.0	44.0
111	Qani Xhafa	PD-PDIU	M	0.0	0.0	5.0	4.0	0.0	0.0	9.3	2.0	20.3
112	Ramadan Likaj	PD	M	3.0	0.0	6.0	4.0	3.0	0.0	10.0	5.0	31.0
113	Saimir Hasalla	PS	M	0.0	0.0	3.0	8.0	0.0	0.0	9.3	3.0	23.3
114	Saimir Korreshi	PD	M	4.0	0.0	11.0	10.0	4.0	0.0	10.0	7.0	46.0
115	Sali Berisha*	PD	M	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.0	1.0
116	Seladin Jakupllari	PD2	M	0.0	0.0	0.0	6.0	0.0	3.0	10.0	2.0	21.0
117	Shkelqim Bullari	PS	M	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	10.0	2.0	12.0
118	Shpëtim Idrizi	PDIU	M	0.0	0.0	3.0	0.0	0.0	0.0	10.0	7.0	20.0
119	Shpresa Marnoj	PS	F	0.0	0.0	4.0	6.0	0.0	0.0	10.0	4.0	24.0
120	Sorina Koti	PD	F	2.0	0.0	7.0	6.0	3.0	0.0	10.0	4.0	32.0
121	Tatiana Piro	PS	F	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	10.0	2.0	12.0
122	Teuta Ramaj	PS	F	0.0	0.0	4.0	4.0	0.0	0.0	10.0	2.0	20.0
123	Tomor Alizoti	PD	M	0.0	0.0	4.0	6.0	0.0	0.0	10.0	4.0	24.0
124	Toni Gogu	PS	M	3.0	0.0	9.0	8.0	3.0	0.0	10.0	5.0	38.0
125	Tritan Shehu	PD	M	3.0	0.0	16.0	14.0	3.0	10.0	10.0	8.0	64.0
126	Vangjel Dule	PBDNJ	M	0.0	0.0	3.0	0.0	0.0	0.0	10.0	5.0	18.0
127	Vullnet Sinaj	PS	M	3.0	0.0	8.0	8.0	3.0	0.0	10.0	5.0	37.0
128	Xhelal Mziu	PD	M	4.0	0.0	11.0	8.0	3.0	0.0	10.0	6.0	42.0
129	Xhemal Qefalia	PS	M	3.0	0.0	6.0	12.0	3.0	0.0	10.0	5.0	39.0
130	Zheni Gjergji	PD	F	3.0	0.0	7.0	16.0	3.0	0.0	10.0	5.0	44.0

*Ministrat dhe kryetari i Kuvendit nuk janë përfshirë në renditje, kurse deputeti Berisha nuk ka qenë pjesë e aktivitetit parlamentar për arsyet e njohura.